REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 119/17
Datë/Datum. 15-05-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEWBODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	119/17
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren - Parashtruesit të ankesës **"DWH-Kosova" sh.p.k.** me seli në Prishtinë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit Bullatovci Idriz Hoxha, Ekspert teknik
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **"DWH-Kosova" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 119/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me GPS",** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	15.05.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me GPS",** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)–Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"DWH-Kosova" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 61/119.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		02.05.2017		02.05.2017		15.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 21 prill 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"DWH-Kosova" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me GPS",** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Hidroregjioni Jugor-Prizren .
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "DWH-Kosova" sh.p.k. me seli në Prishtinë

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia ne trajtim dhe jo diskriminim

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Kërkohet specifika e një prodhues të vetëm, çka nuk lejohet nga LPP-ja, duke favorizuar dukeshim, dien për diell një prodhuesi dhe duke refuzuar ose diskriminuar prodhuesit e tjerë.
Kërkohen 226 kanale, kur të kapshme janë jo më shumë se 20 satelite.
Pra mund të kërkohen 70, 80, 90 100. Por mund të kërkohen ne rast se duhen produkte maksimalisht të mira mbi 400, 410 apo 420.
Por nuk mund të kërkohet 226 tamam si edhe jepet ne datasheet të prodhuesit të para preferuar.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1).....

Data e njoftimit për kontratë (N. 40) 04.04.2017

Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....Procedura e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim /e mesme

Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19): .....15,000.00 € 36muaj

Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9): .....

Afati kohor për pranimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 28.04.2017

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): .....Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët.

Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N. 65-69):

- Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042. për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .Neni 65.
- Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit, jo me e vjetër se 90 dite nga data e lëshimit.
- Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush"Kërkesat e përshtatshmërisë" të mos jetë më i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Dëshmitë dokumentare:

- Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.
- Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje).
- Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).
- Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzimit të dokumenteve të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N. 66):

- Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
- Regjistrimi i numrit fiskal
- Regjistrimi i TVSH-se

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Kopja e certifikatës së biznesit;
- Kopja e numrit fiskal
- Kopja e certifikatës së TVSH-se

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

- Minimum një projekte te furnizimit te natyrës se ngjashme te realizuara ne tri vitet e fundit, (2014,2015 dhe 2016),e vërtetuar nga OE,ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Lista e projekteve te natyrës se ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit(2014,2015,2016) nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike,kurse Origjinale për dosjen në kopje fizike,të dëshmuara me një reference –(kopje)

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Furnizim me GPS"**, me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike furnizim, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit teknik (nenit 18 pika 13 e Rregullores së Punës se OSHP-së)

Sqarimi: Nr. 2

Pranohet jo plotësisht ankesa e OE "DWH Kosova", e cila ankesë është bërë për tenderin e shpallur nga AK KRU "HidroRegjioni Jugor". Pas shqyrtimit të rastit dhe kërkimeve që kam bërë, si dhe pas ofrimit të dëshmive shtesë të ofruara nga OE, përfundojë që është vetëm një prodhues dhe një kompani që ofron GPS me 226 kanale, që paraqet favorizim të vetëm të një OE, duke përjashtuar OE të tjera nga mundësia e konkurrimit. Mirëpo këtu shihet edhe tendenca e OE "DËH Kosova" që ankesa është bërë nga pamundësia e OE "DËH Kosova" për të ofruar këtë produkt.

Nga ana tjetër AK KRU "HidroRegjioni Jugor", edhe përkundër arsyetimit (për shkak të specifikave të terrenit), ka kërkuar një pajisje GPS 226 kanalesh e që kriteret për këtë pajisje mund t'i ofrojë vetëm një prodhues dhe vetëm një OE. Nga kjo shihet që paraqet favorizim të një OE. Prandaj duhet që AK KRU "HidroRegjioni Jugor", të rishqyrtojë specifikat teknike për pajisjen dhe të krijojë hapësirë që të mund të konkurrojnë edhe të tjerë OE.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues/Teknik

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e **"Furnizim me GPS"**, me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, i propozon i panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovoj si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për kontratë, të dt. 04 prill 2017.